

V E N D I M
Nr.306, datë 15.5.2003

**PËR MIRATIMIN E AMENDAMENTIT NR.1 TË KONTRATËS ME NDARJE PRODHIMI,
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË DHE SHOQËRIVE OMV (ALBANIEN)
ONSHORE EXPLORATION GMBH DHE HELENIC PETROLEUM SA PËR KËRKIMIN
DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË BLLOQET 4 DHE 5 NË TOKËN
SHQIPTARE**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e amendamentit nr.1 të kontratës me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe të shoqërive OMV (Albanien) Onshore Exploration GmbH dhe Helenic Petroleum s.a., për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në blloqet 4 dhe 5 në tokën shqiptare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

AMENDAMENTI NR.1

**I KONTRATËS ME NDARJE PRODHIMI PËR KËRKIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË BLLOQET 4 DHE 5 NË TOKËN SHQIPTARE NDËRMJET
MINISTRISË SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT TË PËRFAQËSUAR NGA
AGJENCIA KOMBËTARE E HIDROKARBUREVE DHE OMV (ALBANIEN) ONSHORE
EXPLORATION GMBH DHE HELENIC PETROLEUM SA**

Tiranë, më 29.8.2001

AMENDAMENTI NR.1

Amendament nr.1 është bërë dhe hyn në fuqi ndërmjet palëve në datën 29 gusht të vitit 2001 prej dhe ndërmjet:

Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (referuar këtej e tutje si “Ministria”), e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve (referuar këtej e tutje si “Akh”), një agjenci shtetërore e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë

dhe
OMV (Albanien) Oshore Exploration GmbH, (referuar këtej e tutje si “OMV”), një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Austrisë, zyra e regjistrimit të të cilës ndodhet në Otto-Wanger-Platz 5, 1090 në Vienë, Austri,

dhe
Helenic Petroleum s.a. (referuar këtej e tutje si “Helenic”), një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Greqisë, zyra e regjistrimit të të cilës ndodhet në 54 Amalias Ave., GR-10558 Athinë, Greqi.

Kur konteksti i këtij amendamenti e kërkon, të dy, OMV dhe Helenic, do të referohen kolektivisht si “Kontraktori” dhe të dy, AKH dhe Kontraktori, do të referohen kolektivisht si “Palët”.

SFONDI

Meqë, bazuar në “Ligjin për hidrokarburet” nr.7746, datë 28.7.1993, të amenduar me ligjin

nr.8297, datë 4.3.1998, më 19 janar 1998, Ministria dhe Kontraktori kanë hyrë në një Marrëveshje me ndarje prodhimi (referuar këtu e më poshtë si P.S.C.) për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në blloqe 4&5, çka është miratuar me vendimin nr.235 të 10 prillit 1998 e të amenduar me vendimin nr.395 të 24 qershorit 1998 të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë;

meqë nëpërmjet vendimit nr.445 të 3 shtatorit 1993 të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve përfaqëson Ministrinë në operacionet hidrokarbure në përputhje me ligjin dhe vetë P.S.C;

meqë, AKH-ja dhe Kontraktori dëshirojnë të amendojnë aneksin “A”- “Përshkrimi i zonës së kontratës” dhe aneksin “B”- “Harta e zonës së kontratës” të P.S.C. në përputhje me termat e saj, atëherë, për rrjedhojë AKH-ja dhe kontraktori bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizimet

Termet e përdorua në këtë amendament do të kenë kuptimin që u është dhënë në P.S.C.

Neni 2 Aneksi “A” Zona e kontratës

Nën titullin “Koordinatat gjeodezike të bllokut 5 në tokën shqiptare” janë shtuar edhe tri koordinata të reja menjëherë pas pikës 10.

11.400 25’ 54.28” N190 18’ 25.00” E

12.400 25’ 20.00” N190 21’ 36.00” E

13.400 25’ 20.00” N190 29’ 23.00” E

Në fund të paragrafit “Shpjegime”, nën të njëjtin titull “Koordinatat gjeodezike të bllokut 5 në tokën shqiptare”, është shtuar fjalëzimi i mëposhtëm:

“Linja tokësore midis pikave 11 dhe 12 dhe pikave 1 dhe 13 është përcaktuar si linja e bregdetit në lartësinë mesatare të ujërave midis baticës dhe zbaticës.

Për mënjanimin e çdo dyshimi, e gjithë ajo pjesë e Gjirit të Vlorës që ndodhet në jug të vijës 12-13 (Aneksi “B”) dhe që kufizohet nga vija tokësore e Gjirit të Vlorës, është tashmë pjesë e zonës së kontratës”.

Neni 3 Aneksi “B” Harta e zonës së kontratës

Si pasojë e koordinatave të reja të shtuara, siç jepet në nenin 2, harta e zonës së kontratës që përshkruan bllokun 5 në tokën shqiptare, është rivizatuuar si bashkëlidhur këtij amendamenti.

Neni 4 Klauzola e përgjithshme

Të gjithë klauzolat e tjera të përcaktuara në P.S.C do të vazhdojnë të kenë fuqi dhe efekt të plotë.

Neni 5 Aprovimi i amendamentit të marrëveshjes


Kur aprovohet nga Këshilli i Ministrave, ky amendament do të jetë detyrues për Palët që prej datës efektive të kontratës. AKH-ja do të informojë Kontraktorin me shkrim mbi aprovimin e këtij amendamenti nr.1 brenda pesë (5) ditësh-pune pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave.

Si dëshmi këtij, amendament nr.1 është nënshkruar nga AKH-ja dhe Kontraktori në datën e përcaktuar së pari më lart.

Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve
OMV (Albanien) Onshore Exploration GmbH
Helenic Petroleum s.a.

ANEKSI "B"

HARTA E ZONES SE KONTRATES Blloku 5 ne Toke



ALBANIA

Licensed Exploration Areas

